



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KRM PASTRIMI SH.A PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të KRM Pastrimi sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të KRM Pastrimi sh.a (KRM Pastrimi), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të bashkangjitura ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për pozitën financiare të KRM Pastrimi sh.a deri me 31 dhjetor 2023, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përshkruara më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të KRM Pastrimi sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Kontrata "Furnizim me naftë verore dhe dimërore" me vlerë të parashikuar 2,100,000€ ishte tejkaluar për 22,33% nga vlera e planifikuar, duke anashkaluar kriterin e përfundimit të kontratës në momentin kur shpenzohet buxheti i zotuar.
- B1 Kompania nuk kishte bërë harmonizime në baza periodike me klientët e saj. Ne kemi dërguar 20 letër konfirmime tek palët e treta/klientët në vlerë të përbashkët 683,935€, dhe prej tyre për 18 klientë nuk kemi pranuar fare konfirmime me vlerë të përbashkët 244,067€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KRM Pastrimi sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i KRM Pastrimi sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të KRM Pastrimi sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRM "Pastrimi", sh.a, Prishtinë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të KRM Pastrimi sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e KRM Pastrimi sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjetjet që ka ndikuar në opinionin e pajtueshmërisë janë mungesa e konfirmimeve për llogaritë e arkëtueshme dhe tejkalimi i buxhetit të zotuar për kontratë publike kornizë. Ndërsa çështjet apo gjetjet tjera të cilat kanë ndikuar vetëm te menaxhimi financiar janë: mospërputhja e gjendjes së pasurive ndërmjet pasqyrave financiare dhe shënimeve kontabël, ndarja e tenderëve dhe mos planifikimi i procedurës së hapur; si dhe mangësi në konkurset e shpallura për rekrutim të stafit.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, dhe pesë (5) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Tejkalimi i buxhetit të zotuar për Kontratë Publike Kornizë

Gjetja

Sipas neni 1 pika 1.4 të kontratës publike kornizë "Furnizim me naftë verore dhe dimërore" është specifikuar se: Kjo kontratë planifikohet të hyn në fuqi me datën 05.05.2021 dhe përfundon më datën kur mbushen 36 Muaj apo në ditën kur shpenzohet buxheti i zotuar për këtë kontratë, varësisht se cila përfundon me herët.

Në vitin 2021, Kompania kishte nënshkruar kontratë kornizë për 36 muaj "Furnizim me naftë verore dhe dimërore" në vlerë të parashikuar 2,100,000€. Gjatë testimit kemi vërejtur se janë bërë furnizime me naftë në vlerë 2,568,860€ apo 22,33% më shumë se vlera e kontratës, duke anashkaluar kriterin e kontratës ku është paraparë se kontrata përfundon në momentin kur shpenzohet buxheti i zotuar.

Edhe pse menaxheri i kontratës kishte njoftuar për shpenzimin e vlerës së buxhetit të zotuar me kontratë, furnizimi dhe tejkalimi i kontratës sipas menaxhmentit ishte për arsye të rritjes së vazhdueshme të çmimit të naftës në bursë.

Ndikimi

Realizimi dhe pranimi i furnizimeve pas përfundimit të vlerës së kontratës mund të shkaktoj shpenzime më të larta se sa ato të planifikuara me plan biznesi dhe shpenzime më të larta se çmimi i tregut.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve të sigurojë kontrolle të duhura përmes zyrtarëve përgjegjës në mënyrë që të respektohen dispozitat ligjore, përkatësisht kushtet të pagesave dhe afateve të fillimit dhe përfundimit, që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit të tyre kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos harmonizimi i gjendjes kontabël dhe llogarive të klientëve/furnitorëve

Gjetja Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, në neni 12, pika 1 dhe 2, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre zërave dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Gjatë testimit të llogarive të pagueshme dhe arkëtueshme kemi vërejtur si vijon:

- Te llogaritë e arkëtueshme tregtare, për të testuar saktësinë, përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar 20 konfirmime tek palët e treta apo klientët me vlerë të përbashkët prej 683,935€. Prej tyre kemi pranuar vetëm një (1) konfirmim, ku shuma e borxhit që nuk përputhej me shumën e konfirmimit ishte në vlerë 11,454€. Sa i përket 19 klientë tjerë që kemi dërguar letër konfirmim, kompania për një (1) klientë me vlerë 92,863€ kishte iniciuar procedurë gjyqësore ndërsa për 18 klientët tjerë nuk kemi pranuar fare konfirmime, vlera e të cilave ishte 244,067€.
- Po ashtu, edhe te llogaritë e pagueshme përveç procedurave tjera, ne kemi dërguar 13 letër konfirmime tek palët e treta/furnitorët me vlerë të përbashkët prej 1,732,039€. Prej këtyre, kemi pranuar 11 letër konfirmime me vlerë 1,640,429€, ku shuma e vlerës që nuk përputhej me shumën e konfirmimit ishte në vlerë 10,022€. Ndërsa për një (1) furnitorë me vlerë të borxhit 17,342€, kompania kishte iniciuar procedurë gjyqësor.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos aplikimit të harmonizimeve në baza periodike dhe komunikimit jo të mjaftueshëm të kompanisë me furnitorët dhe klientët e saj, edhe pse menaxhmenti ishte zotuar në planin e veprimit se do të adresonte këtë çështje.

Ndikimi Mos harmonizimi vjetor i të dhënave të kompanisë dhe kartelave të klientëve/furnitorëve të saj, mund të ndikojë në prezantimin e mbivlerësuar/nënvlerësuar të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshmeve në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes kompanisë, klientëve dhe furnitorëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e kompanisë dhe vizitave te furnitorët dhe debitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të detyrimeve dhe kërkesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e zërit financiar të pasurive afatgjata e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 4,768,779€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me tokën, ndërtesat, pajisjet dhe makineritë, inventari, pajisjet dhe softuer kompjuterik. Për këto, kemi testuar 49 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 4,444,433€. Përveç kësaj, kemi kryer procedurat analitike substanciale për popullacionin në tërësi sa i përket zhvlerësimit.

Çështja B2 - Mospërputhje e gjendjes së pasurive në pasqyrën e pozicionit financiar dhe komisionit verifikues të pasurisë

Gjetja

Bazuar në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 12 të Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, shoqëritë tregtare të paktën një herë në vit duhet të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre zërave dhe dëshmive të tyre mbështetëse. Rezultatet nga raporti i inventarizimit duhet të barazohen me librat kontabël.

Kompania nuk ka arritur të harmonizoj shënimet kontabël me gjendjen pas regjistrimit të pasurive. Ekziston mospërputhje mes gjendjes faktike të pasurisë, evidencave kontabël dhe raportit të komisionit të inventarizimit të pasurisë. Këto janë vërejtur si në vijim:

- Në evidencat kontabël ende figurojnë pasuri me vlerë neto 138€ dhe zhvlerësim të periudhës në vlerë prej 8,246€, të cilat janë shitur për mbeturina gjatë gjysmës së parë të vitit 2022;
- Pasuri me vlerë neto 3,065€ dhe me zhvlerësim të periudhës prej 3,586€ të cilat komisioni i kishte evidentuar si pasuri të humbura në raportin e komisionit vlerësuar të vitit 2022, figurojnë ende në evidencat kontabël;
- Rrjedhimisht vlera e pasurisë e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 3,203€ e po ashtu edhe shpenzimet e zhvlerësimit për 11,832€; dhe
- Komisioni verifikues i pasurisë të kompanisë, në regjistrat e pasurive kishin regjistruar vetëm me sasi pasuritë të ndryshme pa u identifikuar me ndonjë kod të veçantë, gjë që ka pamundësuar krahasimin e regjistrat të komisionit verifikues me regjistrat kontabël të pasurive.

Pas rekomandimit të vitit 2022, kompania ishte zotuar se do të bëjë harmonizimin e gjendjes së pasurisë, mirëpo ende nuk ishin zbatuar dobësitë për këto çështje.

Sipas komunikimeve të menaxhmentit, këto çështje kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti paraprak nuk kishte ndërmarr veprime për të adresuar rekomandimet e auditimit të vitit paraprak. Ndërsa, sa i përket raportit të mangët të komisionit verifikues të pasurisë, kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni nuk kishte treguar kujdes gjatë hartimit të raportit për të përshkruar informatat e sakta.

- Ndikimi** Mungesa e kontrolleve efektive për të identifikuar në mënyrë periodike gjendjen e pasurive në modulin e pasurisë me shënimet kontabël dhe mos harmonizimi i shënimeve pas raportit të vlerësimit ndikon në prezantim jo të drejtë të PFV-ve.
- Rekomandimi B2** Bordi i Drejtorëve të sigurojë se në vazhdimësi është duke u bërë harmonizimi me regjistrat kontabël në mënyrë që të shmangen diferencat të cilat janë paraqitur mes shënimeve kontabël dhe PFV-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara për vitin 2023 ishin 9,032,974€, ku përfshihen të hyrat nga amvisëria, bizneset, institucionet, kontratat dhe arkëtimet e borxheve të vjetra, ndërsa të hyrat nga taksat përmbartimore, grantet dhe të tjera ishin 304,677€. Ne kemi testuar për dy kategoritë e të hyrave 83 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 4,441,887€.

Çështja A2 - Mangësi në faturimin e të hyrave për Komunën e Prishtinës

Gjetja Sipas kontratës të nënshkruar në mes të KRM Pastrimit dhe Komunës së Prishtinës për ofrimin e shërbimeve primare për menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave në të gjithë territorin e Komunës së Prishtinës, neni 8 monitorimi dhe raportimi pika 4 definon se elementet e detyrueshme që duhet të raportohen përfshijnë: sasi të mbeturinave të mbledhura, automjetet e dërguara, numrin e udhëtimeve të përshkruar, numrin e punëtorëve, orët e punës, dhe karburantin e shpenzuar.

Në gjashtë (6) fatura për të hyrat e realizuara për shërbimet e ofruara nga Komuna e Prishtinës kemi vërejtur se mungojnë dëshmi përcjellëse për artikujt e faturuar. Nuk ishin specifikuar artikujt në faturë sipas listës evidentuese për shërbime dhe bartjen e mbeturinave. Vlera e këtyre artikujve të faturuar me dëshmi të mangëta ishte 3,099€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të faturave të lëshuara dhe raporteve për mbledhjen e deponive në terren.

Ndikimi Faturimi i artikujve në mungesë të dëshmive përcjellëse për të hyrat e realizuara ndikon në raportime të pasakta të hyrave dhe gabime në llogaritë financiare.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtoreve të sigurohet se përdoren procedura të përforcuara të kontrollit të brendshëm në faturimin e të hyrave nga Komuna e Prishtinës që të bëhet sipas kriterëve të caktuar në kontratë, si dhe të sigurohet monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm i të hyrave të gjeneruara nga Komuna e Prishtinës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative në vitin 2023 ishin 3,600,776€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzimet e kostos së mallit të shitur, mirëmbajtjes, komunalive dhe ato administrative, shpenzimet e qirasë së veturave, dhe të tjera. Në këto shpenzime, kemi testuar 70 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në shumën 2,296,563€.

Çështja B3 - Ndarja e tenderëve dhe mos planifikimi i procedurës së hapur

Gjetja

Neni 16.4 i LPP thekson se: Vlera e secilës kontratë duhet planifikuar dhe procedura e prokurimit vendoset konform vlerës parashikimit AK nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në Nenin 19 të këtij ligji, i cili citon që "Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se një mijë (1,000€), por më e vogël se dhjetë mijë (10,000€) konsiderohen me vlerë të vogël. Po ashtu edhe paragrafi 1 i nenit 11 të Rregullores mbi menaxhimin e financave dhe shpenzimeve të kompanisë thekson se: Blerjet e jashtëzakonshme apo ditore me vlerë deri 99€ mund të blihen edhe pa ofertues, përderisa për blerjet që tejkalojnë shumën prej 100€ do të veprohet në bazë të LPP-së. Ndërmarrjet publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë detyrim që të respektojnë të gjitha procedurat e LPP-së.

Ne kemi analizuar raportin e kontratave të nënshkruara dhe kemi vërejtur se edhe këtë vit vazhdon praktika e njëjtë se për llojin e njëjtë të furnizimeve/shërbimeve ishin realizuar disa procedura të prokurimit duke rezultuar me ndarje të tenderëve për të njëjtin furnizim/shërbime, si:

Për natyrën e njëjtë të kontratave për riparime të automjeteve kompania kishte nënshkruar:

- Për shërbime dhe furnizime të njëjta për mirëmbajtje të automjeteve janë kontraktuar kontrata katër (4) kontrata në vlera totale 6,099€. Prej tyre tri (3) kontrata ishin me vlera minimale në total 2,670€, dhe një (1) me vlerë të vogël 3,399€.
- Për furnizim me pjesë për automjete, kompania kishte realizuar nëntë (9) kontrata me vlerë totale 31,873€ prej të cilave pesë (5) kontrata ishin me vlerë minimale 4,736€ dhe katër (4) me vlerë të vogël 27,137€.

Po ashtu, kompania kishte bërë furnizime të shpeshta për material dhe pajisje të vogla me vlerë nën 100€ të dedikuara kryesisht për makinerinë e saj, nga OE të ndryshëm, për të cilat nuk kishte lidhur ndonjë kontratë për këto furnizime. Ne kemi vërejtur që shuma e furnizimeve të ngjashme të blerjeve për vitin 2023 ishte 8,929€ nga një operator i vetëm ekonomik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i gjendjes aktuale të rënduar në të cilën ndodhej kompania sa i përket makinerisë së vjetërsuar, gjë që kishte detyruar që disa nga këto aktivitete të zhvillohen të ndara në mënyrë emergjente.

- Ndikimi** Ndarja e tenderëve dhe shmangia nga procedurat e hapura e shtojnë rrezikun që kompania nuk do të arrijë të marrë vlerën për parën e shpenzuar duke ndikuar njëkohësisht edhe në kufizim të konkurrencës.
- Rekomandimi B3** Bordi i Drejtorëve të sigurojë një vlerësim dhe planifikim të duhur të nevojave të ndërmarrjes dhe duke u siguruar që artikujt e ngjashëm grupohen dhe për to përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave ishin 5,916,649€, të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e pagave si dhe kontributet dhe tatimin për to. Në këto shpenzime, kemi testuar 70 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në shumën 51,747€. Po ashtu kemi testuar edhe nëntë (9) mostra për procedura të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Mangësi në proceset e rekrutimit për staf të rregullt

Gjetja

Sipas Udhëzimi Administrativ 07/2017 për përrregullimin e procedurave të rekrutimit në Sektorin Publik, në nenin 10 paragrafi 2 definon se testi duhet të përmbajë njëqind (100) pikë, Çdo pyetje duhet të përmbajë pikët e caktuara; nenin 11, pika 5 definon se në testimin me gojë (intervista), kryetari dhe anëtarët e Komisioni Përzgjedhës, përgatisin nga pesë pyetje të veçanta për çdo pjesëmarrës në testin me gojë (intervistën); në pikën 8 definohet se kryetari dhe anëtarët e Komisioni Përzgjedhës, mbajnë shënime secili veç e veç, shënime të përmbajnë pyetjet e veta për çdo pjesëmarrës në intervistë, përgjigjet, pikët e fituara për çdo pyetje dhe totalin e pikëve. Po ashtu, sipas konkursit të shpallur me datën 15 Shtator 2023 ishte kërkuar që kriteri për kualifikim arsimorë të jetë universitarë gjegjësisht fakulteti juridik.

Gjatë testimit të procedurave të rekrutimit, kemi hasur këto mangësi:

- Pë pozitën “Sekretar i Bordit të Drejtorëve”, Zyrtarë Ligjor, Asistent/e Ekzekutive, Menaxher i Njesisë Operative në Prishtinë, Sekretar i Bordit të Drejtorëve si dhe Pozita Manipulant në Sektorin Komercial “Asistent/e Ekzekutive” - janë vërejtur:
 - Nuk ishin përgatitur nga pesë (5) pyetje të veçanta nga secili anëtarë i Komisionit Përzgjedhës dhe nuk ishin mbajtur shënime gjatë testimit me gojë - intervistë për përgjigjet e dhëna nga kandidatët;
 - Në çelësin e testit me shkrim ku janë pyetjet dhe përgjigjet e sakta, mungon vlerësimi i pyetjeve se sa pikë ka secila pyetje. Po ashtu, edhe në dosjen origjinale të arkivuar mungon çelësi i pyetjeve dhe përgjigjeve të testit me shkrim; dhe
 - Nuk kemi hasur kërkesë nga njësia kërkuuese për fillimin e procedurave të rekrutimit
- Tek pozita “Manipulant”, kandidati fitues nuk ka dhënë përgjigje të sakta në dy pyetje dhe ishte vlerësuar me gjysmën e pikëve.
- Tek pozita “Menaxher i Njesisë Operative” njëri nga kandidatët ishte vlerësuar me pikë maksimale (15 pikë) edhe pse nga katër (4) përgjigje të sakta i kishte rrumbullakuar vetëm tri (3) përgjigje të sakta
- Tek pozita “Zyrtar Ligjor”, dy aplikacione janë lejuar për procedura të rekrutimit më tutje pavarësisht që nuk kishin plotësuar kriterin edukimit, ku ishte kërkuar fakulteti juridik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë gjatë procesit të rekrutimit duke filluar nga iniciimi deri te procesi i përzgjedhjes së kandidatëve.

Ndikimi

Mos përfillja e rregullave dhe udhëzuesit administrativ lidhur me proceset e rekrutimit ndikon në shfaqjen e dobësive në proceset e vlerësimit, e cila mund të ndikojë përzgjedhjen e kandidatëve të jo të suksesshëm.

Rekomandimi B4 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të merren masa e nevojshme që të plotësohen të gjitha udhëzimet për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të konkursit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Ndryshimet në paga jo në përputhje me vendimin

Gjetja Më datë 15.03.2023 është marrë vendim nga Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi "sh.a, me numër të protokollit 832 që të bëhet ngritja e pagave në kategori të caktuara, pika 1.3 e vendimit thotë të bëhet ngritja e pagave prej shtatëdhjetë euro (70€) për pozitat: inkasant i amvisërive, automekanik, axhustator, vozitës i kategorisë C, vozitës i kategorisë C1, vozitës i ngarkuesit (manipulant i makinave të rënda), auto elektrikist, gomiser, lubrifikues, shtëpiak, autolarës, manipulues i skipit.

Kompania nuk kishte ngritur pagat për 14 pozita të inkasantëve, pasi vendimi për rritje lineare të pagave specifikonte vetëm rritje për pozitën inkasant i amvisërisë. Për këto pozita, ne kemi testuar dy (2) raste të cilat pavarësisht që emërtimin e kontratës e kishin si inkasant, ata kryenin detyrat e inkasantit të amvisërisë dhe bizneseve njëkohësisht.

Kjo kishte ndodhur për shkak se kontratat e tyre nuk ishin azhurnuar dhe kishin mbetur me emërtimin në kontratë vetëm si inkasant, mirëpo kryenin inkasimin për amvisëri dhe biznese në të njëjtën kohë.

Ndikimi Mos azhurnimi i kontratave të inkasantëve dhe mos rritja e pagave për të gjitha pozita që kanë përgjegjësitë e njëjtë, ndikon në rritjen e pakënaqësisë dhe mos kryerjen e punëve dhe ofrimin e shërbimeve efektive nga pjesa e mbetur e zyrtarëve që nuk shpërblehen sipas vendimit.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtorëve të sigurohet se janë azhurnuar kontratat e punonjësve si dhe vendimet që merren për rritje të pagave zbatohet tek të gjithë zyrtarët që kanë përgjegjësitë të njëjta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe një aktivitet këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e kompanisë. Po ashtu, ndihmon për përmbushjen e objektivave, duke nxitur një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit në menaxhimin e rrezikut, kontrolleve dhe proceseve të qeverisjes.

Çështja B5 - Mungesa e stafit në NJAB si pengesë e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë

Gjetja

Sipas Standardeve Ndërkombëtare dhe Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm 1300, 1310, 1311, Drejtuesi i Auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguri-dhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, përmes vlerësimeve të brendshme të cilat përfshijnë: monitorime të vazhdueshme të ecurisë së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, si dhe përmes vetëvlerësimeve periodike ose vlerësimeve nga personat të tjerë brenda organizatës, me njohuri të mjaftueshme në praktikatat e auditimit të brendshëm.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm në kompani, kryhet vetëm nga një zyrtar i cili kryen edhe auditimet, edhe bën rishikimin e tyre, gjë që pamundëson sigurimin e një programi efikas të siguri-dhënies dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve audituese. Gjatë vitit 2023, kompania kishte filluar procesi për rekrutimin e një zyrtari të auditimit të brendshëm, mirëpo nuk kishte arritur të përzgjedhë ndonjë kandidat i cili plotëson kriteret e vendosura sipas konkursit.

Po ashtu, zyrtari ekzistues i auditimit të brendshëm kishte arritur periudhën e pensionimit në muajin Korrik 2023, mirëpo Komiteti i Auditimit me një vendim e kishte vazhduar angazhimin e zyrtarit të auditimit të brendshëm deri më 1 Dhjetor 2023.

Derisa ishim në proces të auditimit gjatë vitit 2024 është realizuar procesi i rekrutimit dhe është përzgjedhur një zyrtar në njësinë e auditimit të brendshëm. Por ende vazhdon të jetë numri i pa plotësuar i stafit në Auditimit të Brendshëm.

Kompania kishte shpallur konkurs për rekrutimin me staf shtesë të NJAB-së, por procesi i rekrutimit kishte dështuar për shkak të mos aplikimit të kandidatëve të mjaftueshëm.

Ndikimi

Kryerja e aktiviteteve audituese dhe rishikimi i tyre nga i njëjti zyrtar pamundëson sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.

Rekomandimi B5

Bordi i Drejtorëve të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm, të krijojë një program efikas të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve të brendshme, përmes shtimit të burimeve njerëzore me njohuri të mjaftueshme në praktikatat e auditimit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 Kompensime të zyrtarëve me vendim të shfuqizuar**Gjetja**

Zyrtari Kryesor Financiar, Sekretari dhe Zyrtari i Auditimit të Brendshëm kanë marrë pagë në vlerë 1,200€ nga data 27.06.2023, përkundër vendimit të shfuqizuar të datës 27.06.2023 zyrtarët e lartë cekur kanë vazhduar të paguhen 1,200€ pagë për secilin muaj në vazhdimësi.

Po ashtu, kontrata për pozitën e Këshilltarit të Kryeshefit Ekzekutiv nuk ishte në harmoni me rregulloren për paga, kompensime dhe udhëtime zyrtare në fuqi, ku kjo pozitë sipas kontratës është me pagë 900€, ndërsa në rregullore paga është 767€.

Veprimi i kërkuar

Bordi i Drejtoreve të ndërmarrë masa për ngritje të kontrollit të brendshëm, për menaxhimin, mbikëqyrjen dhe shpenzimin e buxhetit sipas planit të biznesit vjetor të kompanisë.

Rezultati

Kompania ka ndërmarr veprime të nevojshme duke kthyer mjetet e zyrtarëve që kishin marr më tepër. Po, ashtu janë ndryshuar kontratat që nuk kanë qenë në harmoni me rregulloret në fuqi.

Çështja 2**Prezantimi i jo i drejtë i detyrimeve afatshkurta****Gjetja**

Arkëtimet në avans nga konsumatorët me vlerë 92,694€ që kishin parapaguar për shërbimet e pastrimit, ndërmarrja nuk i ka njohur si të hyrat të shtyra-detyrime afatshkurta. Po ashtu kjo shumë nuk ishte zvogëluar as në totalin e llogarive të arkëtueshme.

Ngjashëm, detyrimet për qëllime tatimore ishin prezantuar me vlerë 355,178€, ndërsa në pasqyrën e gjendjes vjetore në Administratën Tatimore të Kosovës detyrimet ishin 123,453€.

Veprimi i kërkuar

Bordi i Drejtorëve të sigurojë se vlera e detyrimeve të njihet dhe prezantohet saktë në PFV, si dhe të marrë masat e nevojshme korigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël.

Rezultati

Kompania ka ndërmarr veprime korigjuese në prezantimin e detyrimeve afatshkurta në pasqyrat vjetore financiare.

Çështja 3**Mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme****Gjetja**

Zëri i llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë prej 2,812,361€, për vitin 2023 nuk është vlerësuar për provizionim të humbjeve bazuar në vjetërsinë e llogarive, dhe si rezultat nuk është njohur as lejimi i humbjes së bilancit të llogarive të arkëtueshme.

Veprimi i kërkuar

Bordi i Drejtorëve të sigurohet që provizionimi i llogarive të arkëtueshme të bëhet në mënyrë periodike me rastin e hartimit të pasqyrave financiare sipas kërkesave të standardit dhe rregullores në fuqi.

Rezultati

Kompania ka bërë korrigjimin e nevojshëm duke bërë njohur provizionimin e llogarive të arkëtueshme sipas rregullores së përgjithshme për provizionimin e llogarive të arkëtueshme në fuqi dhe kërkesat e standardeve, e cila ka rezultuar në prezantim të saktë të llogarive të arkëtueshme.

Çështja 4**Mos prezantim i saktë i parapagimeve****Gjetja**

Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se zëri i parapagimeve të marra nga punëtorët është prezantuar 3,255€, ndërsa sipas evidencave kontabël parapagimet e dhëna punëtorëve ishin 6,354€. Kjo zë në pasqyrat vjetore financiare ishte nënvlerësuar për vlerë 3,099€.

Veprimi i kërkuar

Bordi i Drejtues të sigurojë, që në datën e hartimit të pasqyrave financiare të prezantohen parapagimet që lindin nga veprimet rregulluese për to, si dhe të sigurojë se janë marrë masat e nevojshme korrigjuese për të pasur një prezantim të drejtë të parapagimeve.

Rezultati

Kompania ka bërë korrigjimin e nevojshëm në zërin e parapagimeve, e cila ka rezultuar me prezantim të drejtë të pasurisë në pozicionin financiar.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të KRM Pastrimi sh.a. ka rezultuar në 16 rekomandime kryesore. KRM Pastrimi sh.a. kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2023, 11 rekomandime janë zbatuar , dhe pesë (5) tjera nuk janë zbatuar. Për më hollësisht, shih më poshtë Grafikonin 1. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 1 të rekomandimeve të vitit paraprak.

Gjatë vitit 2023, kompania kishte arritur të zbatonte çështjet si: shitja e pasurive jashtë përdorimit-skrupit, mungesë e vlerësimit formal të nevojave dhe aprovimit të tyre për procedurat me vlerë të vogël dhe kuotimet, dobësi në hartimin e specifikimeve teknike, mos nënshkrimi i kontratave nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, pranim-dorëzim i shërbimeve jo me dëshmi përcjellëse, evidenca për vijueshmërinë në punë, tejkalimi i numrit të punonjësve dhe shpenzimeve të pagave të planifikuara sipas planit të biznesit, punësimi i punonjësve me kontrata me afat të caktuar për punë dhe detyra specifike pa zhvillim të procedurave të rekrutimit, planifikim jo i duhur i prokurimit, si dhe faturimi i klientëve pa emërtim të saktë.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|---------------------|---|---|-----------|
